



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Department Slobodnih Profesija -
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.17/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, **P.nr.203/2021**, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, përfaqësuesi i palës ankuese, dhe Përmbaruesi Privat, me datë 23.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-17/2022 i datës 17.05.2022 dhe ankesa e palës ankuese e dates 15.05.2022, **si të Pabazuara.**

II. Përmbaruesi Privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore , P. nr. 203/2021.

A r s y e t i m

Me datën 15.05.2022 pala ankuese , ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit, me pretendimin se përmbaruesi privat , përkundër që ka dalur dy herë në vend të ngjarjes me qëllim të përmbarimit të Aktgjykimit, C.nr.483/2019 të Gjykatës Themelore në , pala ankuese figuron që është pronar i ngastrës lëndore dhe përmbaruesi sipas vendimit të gjykatës ,do duhej t' ia dorëzoj në shfrytëzim palës ankuese.

Përmbaruesi ka dalur dy herë me qëllim të përmbarimit dhe përkundër premtimit, nuk e ka përfunduar përmbarimin.

Në seancën dëgjimore pala ankuese ka deklaruar se meqë vendimi ka marrë formën e prerë për fitimin e pronësisë dhe në procedurë të përmbarimit është ushtruar prapësim , ka përfunduar në favorin e tyre,

kanë dalur në vend të ngjarjes për ekzekutim të vendimit të gjykatës dy herë radhazi, ndërsa herën e tretë kur ata kanë dalur me polici për ekzekutim, pasi që janë sanuar të metat e ekzekutimit, Përmbauesi privat është tërhequr për ekzekutimin e mëtejme të këtij rasti. Ka theksuar më tutje se nuk ka dijeni për arësyet e tërheqjes së përmbauesit deri në këtë seancë. nuk e kam ditur atëherë e nuk e di as deri me tani në këtë seancë.

I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmerren masa ndaj përmbauesit privat.

Me datën 17.05.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbauesin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbauesit privat, lidhur me veprimet përmbauese për këtë lëndë.

Përmbauesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka deklaruar se sa i përket pretendimit të palës ankuese, të njëjtat nuk qëndrojnë, ngase sipas tij ai ka dalur me qëllim që të kryej përmbauesin, por janë evidentuar pamundësi për përmbauesin si dhe prona tani ka ndërruar pronar. Për këtë arsye përmbauesi ka shtuar se i ka ndaluar veprimet, për arsye se është pala e tretë, respektivisht shfrytëzuesi i lokalit ka bërë ankesë dhe gjykata ende nuk ka vendosur lidhur me prapësimin. Normalisht pala ankuese këtu prezente është hidhëruar, revoltuar sepse nuk kanë qenë në dijeni për ushtrimin e prapësimin nga pala e tretë, pasi që të njëjtat nuk janë njoftuar fare nga avokati i tyre për arsyet e ndaljes së veprimeve përmbauese, për shkak të këtij prapësimi të palës së tretë. Prandaj është ndaluar ekzekutimi deri në vendosjen mbi prapësimin në gjykatë, sipas prapësimin të palës së tretë – shfrytëzuesit të lokalit. Për këto i ka dorëzuar edhe provat sikurse procesverbalet e daljes në terren.

I ka propozuar komisionit që të refuzohet në tërësi ankesa si e pabazuar.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbauesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së,

Këtë konstatim komisioni e bazon në shkresat e Indës, ku shihet se përmbauesi ka dalur në përmbauesin të vendimit të gjykatës, pasi që urdhëri është bërë i përmbaueshëm. Fillimisht, ka hasur në pamundësi të përmbauesin, por është tentuar që të eliminohen pamundësitë lidhur me shenjzimin e njësisë kadastrale që ka qenë objekt përmbauesi dhe dorëzimi tek kreditori, duke shënuar saktë kufinjët. Më tutje, përmbauesi ka hasur në një gjendje faktike të tillë e cila e ka bërë të pamundur përmbauesin e vendimit të gjykatës në atë formë dhe në ndërkohë edhe pala e tretë si shfrytëzuese e paluajtshmërisë lëndore, ka parashruar prapësim dhe sipas deklaratave të vet palëve, lënda ende nuk është vendosur sipas prapësimin të palës së tretë.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.17/2022 datë 23.09.2022

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.